

Kastrati Construction SHPK

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024.


KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)*

Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2024

AKTIVI	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktive aftashkurtra			
Mjete monetare dhe të ngjashme	1	4,670,569	168,462,643
Të drejta të arkëtueshme	2	4,491,962,222	5,571,829,066
Inventare	3	9,080,318,341	8,856,163,570
Shpenzime per tu shperndare	4	390,634,377	231,528,507
Total - Aktive afatshkurtra		13,967,585,508	14,827,983,786
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	101,390,348	116,747,905
Aktive afatgjata jomateriale	6	4,344,366	-
Total - Aktive afatgjata		105,734,714	116,747,905
TOTALI AKTIVI		14,073,320,223	14,944,731,692
PASIVI			
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime te pagueshme furnitor	7	4,363,754,730	2,921,884,515
Arketime ne avance per porosi	8	5,412,555,594	6,378,497,264
Detyrime Personeli dhe sigurime shoqerore	9	12,001,821	5,984,429
Huatë nga institucionet financiare (over draft)	10	1,009,781,147	1,159,645,400
Detyrime te tjera	11	66,136,587	781,758,295
Total - Detyrime afatshkurtra		10,864,229,879	11,247,769,904
Detyrime afatgjata			
Detyrime te treteve (Financime ortaku)	12	2,618,955,918	3,183,614,610
Huatë detyrime ndaj institucioneve financiare	13	90,481,511	140,404,927
Total - Detyrime afatgjata		2,709,437,429	3,324,019,537
KAPITALI			
Kapitali aksionar	14	181,400,000	181,400,000
Fitime dhe humbje te mbartura		191,542,251	178,360,129
Fitim/(humbje) i vitit ushtrimor		126,710,664	13,182,122
Total – Kapitali		499,652,915	372,942,251
TOTALI KAPITALI DHE DETYRIMET		14,073,320,223	14,944,731,692

ADMINISTRATOR

Drejtore i Departamentit te Finances

*Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.*

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)***Pasqyra e Performances**

Te ardhurat dhe shpenzimet

Pershkrimi i elementeve	Shenime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	4,224,917,714	2,682,047,524
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit		54,343,599	3,664,485
Totali te ardhura		4,279,261,313	2,685,712,008
Lenda e pare dhe materiale te tjera te konsumueshme	16	(2,552,739,382)	(1,377,096,513)
- Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(2,473,403,364)	(1,342,014,380)
- Te tjera shpenzime		(79,336,017)	(35,082,132)
Shpenzime te personelit	17	(261,878,727)	(215,156,455)
- Paga dhe shperblime		(228,027,264)	(185,963,587)
- Shpenzime sigurime shoqerore dhe shendetsore		(33,851,463)	(29,192,868)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18	(20,522,369)	(18,738,285)
Shpenzime te tjera shfrytëzimi	19	(1,146,984,983)	(1,019,584,754)
Te ardhura te tjera	20	(12,229,411)	129,346
- Interesa dhe te ardhura te tjera (vlera neto e AAM)		(12,229,411)	-
- Te ardhura rimarje provizionesh te patatueshme		-	-
- Te ardhura te tjera		-	129,346
Te ardhura /(Shpenzime) financiare		(134,062,997)	(38,097,755)
- Shpenzime interesi dhe te ngjashme te dhena me interes	21	(77,746,102)	(55,101,812)
- Te ardhura te tjera fitime /(humbje) neto nga kursi kembimit	22	(56,316,896)	17,004,057
Fitimi /Humbja para tatimit	23	150,843,444	17,167,594
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(24,132,780)	(3,985,472)
- Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(24,132,780)	(3,985,472)
Fitimi /Humbja neto		126,710,664	13,182,122
Te ardhura gjithë përfshirëse (Fitim /Humbje nga pjesëmarrjet)		-	-
Fitimi dhe te ardhurat gjithë përfshirëse		126,710,664	13,182,122

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare***(Metoda indirekte)*

Nr	Pershkrimi i elementeve	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
I	Fluksi i Mjeteve Monetare perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		
1.	Fitim /Humbja e vitit	126,710,664	13,182,122
2.	Rregullimet per shpenzimet jomonetare	20,522,369	18,738,285
2.1	Shpenzime fiannciare jomonetare		
2.2	Shpenzimet per tatimin mbi fitimin jomonetar		
2.3	Shpenzime per konsumin dhe amortizimin	20,522,369	18,738,285
2.4	Zhvlersim i aktiveve afatgjata materiale		-
3.	Fluksi i Mjeteve Monetare i perfshire ne aktivite investuese		-
3.1	Vlera neto kontabile e aktiveve afatgjata materiale te shitura		-
4.	Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit	462,930,428	(717,102,256)
4.1	(Rritje)/renie ne te drejta te arketueshme dhe te tjera	1,079,866,845	(1,583,715,248)
4.2	(Rritje)/renie ne inventare	(224,154,771)	(2,161,908,055)
4.3	(Rritje)/renie ne parapagime/shpenzime te shtyra	(159,105,870)	1,493,757,454
4.4	(Rritje)/renie ne detyrime furnitore	1,441,870,215	760,608,195
4.5	Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme	(1,675,545,991)	774,155,399
	Totali Mjete monetare te perdorura ne aktivitetin e shfrytezimit	610,163,461	(685,181,849)
II	Fluksi Mjete monetare te perdoura ne aktivitetin e investimit		
1	Para neto fitime nga pjesmarrjet ne shoqeri te tjera		-
2	Para neto te arketuar humbje nga pjesmarja		-
3	Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(21,738,584)	(45,927,894)
4	Pakesime te aktiveve afatgjata materiale	12,229,411	-
5	Pagesa per dividendin		-
	Totali Mjete monetare te perdorura ne aktivitetin e investimit	(9,509,173)	(45,927,894)
III	Fluksi i mjeteve Monetare te perdorura ne aktivitetin e financimit		
1	Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral		-
2	Arketime/pagesa financime ortake	(564,658,693)	(310,763,231)
3	Arketim /(Pagesa) te huave bankare	(199,787,669)	1,073,201,553
4	Pagesa e detyrimeve te qirase financiare		-
	Totali i Mjeteve Monetare te perdorura ne aktivitetin e financimit	(764,446,362)	762,438,322
IV	Rritje/(renie) ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare	(163,792,074)	31,328,580
V	Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim te vitit	168,462,643	137,134,063
VI	Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare		-
VII	Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund te vitit	4,670,569	168,462,643

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto

Nr	Pershkrimi	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e pashpërdara	Fitim / Humbja e vitet	Totali
1	Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2023	181,400,000	-	-	-	-	-	305,045,029	- 126,684,900	359,760,129
2	Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2023(1+2)	181,400,000	-	-	-	-	-	305,045,029	- 126,684,900	359,760,129
4	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin :									
5	Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	13,182,122	-	13,182,122
6	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin (5+6)	-	-	-	-	-	-	13,182,122	-	13,182,122
8	Transaksionet me pronarët e njësise ekonomike të njohura direkt në kapital:									
9	Emelimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
11	Totali i transaksioneve me pronarët e njësise ekonomike (9+10)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12	Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2023 (3+7+11)	181,400,000	-	-	-	-	-	318,227,151	- 126,684,900	372,942,251
13	Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2024 (12 = 13)	181,400,000	-	-	-	-	-	191,542,251	-	372,942,251
14	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin:									
15	Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	126,710,664	-	126,710,664
16	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin (15+16)	-	-	-	-	-	-	126,710,664	-	126,710,664
18	Transaksionet me pronarët e njësise ekonomike të njohura direkt në kapital:									
19	Emelimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
20	Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
21	Totali i transaksioneve me pronarët e njësise ekonomike (19+20)	-	-	-	-	-	-	-	-	-
22	Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024 (13+17+21)	181,400,000	-	-	-	-	-	318,252,915	-	499,652,915

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Shoqëria **Kastrati Construction shpk** është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 23/05/2016, me NUIS L61723012R me seli në adresën: "Rruga Skerdilajd Llagami, numer pasurie 7/63, Zona Kadastrale 8160, Vol 46, Fq. 160, Tirane, dhe ushtron aktivitetin e saj me objekt ekonomik Investimi me qëllim zhvillimin, ndërtimin, administrimin dhe shitjen e një godine multifunkionale banimi dhe shërbimesh si një Projekt i Shoqërisë ("Projekti") me vendndodhje tek: Blv. Bajram Curri në krah të European Trade Center (ETC), Tirane. Ndërtim, Projektim, konsulentë, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit. Import-eksport i të gjithë llojeve të materialeve dhe makinerive të ndërtimit. Ndërtim, përmirësim, mirëmbajtje të rrugëve, autostradave, mbikalimeve dhe nenkalimeve, urave, tuneleve, porteve, aeroporteve, digave, hidrocentraleve dhe veprave të tjera të infrastruktures, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjetër hotelieri dhe supermarketet. Ortaku i vetëm i shoqërisë është personi juridik shoqëria **KASTRATI ENERGY TRADE** sh.a me seli në Durrës e cila me datë 31.12.2024 zoteron 100 % të kapitalit të shoqërisë **Kastrati Construction shpk**. Administratori i shoqërisë është z. Viron Hamzai

BAZA E PËRGATITJES

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur duke përdorur bazën e përllogaritjes të specifikuar nga SNRF për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur dhe paraqitur në monedhën shqiptare Lek ("LEK"), monedhë e vëndit në të cilin shoqëria zhvillon aktivitetin. Politikat kryesore kontabël janë shpjeguar më poshtë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara.

Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare individuale. Vlerësimi kontabël më i rëndësishëm për kompaninë është ai që lidhet me rekuperueshmërinë e llogarive të arkëtueshme. Administratorët e kompanisë klasifikojnë si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme momentin kur marrëdhëniet e biznesit me klientin janë ndërprerë dhe kanë filluar proceset gjyqësore që lidhen me klientin.

Vijimësia

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimesisë, i cili supozon se shoqëria do të vazhdojë të operojë për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Drejtimi i shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

per te siguruar qendrueshmeri dhe zhvillim te biznesit te shoqerise ne kushtet aktuale. Aftesia e shoqerise per te vazhduar aktivitetin do te varet gjithashtu dhe nga mbeshtetja financiare nga aksioneri i saj.

POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Standardet e miratuara dhe efektive për periudhën aktuale

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2024, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek shoqeria :

- Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (publikuar më 25 maj 2023 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024)
- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (lëshuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- Klasifikimi i detyrimeve si korrente ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1 (fillimisht i lëshuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2024);

Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqeria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

Ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për shoqerine , por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- Ndryshime në SNK 21 Mungesa e Këmbyeshmërisë (Lëshuar më 15 gusht 2023 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025).
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare - Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7 (publikuar më 30 maj 2024 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026).
- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 18 Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare (Lëshuar më 9 Prill 2024 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2027).
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit SNRF (Lëshuar në korrik 2024 dhe në fuqi nga 1 janari 2026).

Instrumentat Financiare.

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. në vijim të njohjes fillestare. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parase së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Aktive financiare.

**Njohja dhe matja*

Aktivitetet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, dhe më pas maten me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes. Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, është e nevojshme të sjellë flukse të parasë.

Megjithatë, në disa raste, shoqëria mundet gjithashtu që ta konsiderojë një aktiv financiar në vonesë pagese, atëherë kur informacioni i brendshëm ose i jashtëm tregon që shoqëria ka pak mundësi të arkëtojë të plota shumat e mbetura kontraktuale para se të konsiderojë metodat e uljes së riskut të kredisë. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka asnjë tregues të arsyeshëm që flukset kontraktuale të parasë do të arkëtohen.

Detyrimet financiare.

**Njohja fillestare dhe matja*

Detyrimet financiare, në njohjen fillestare, klasifikohen si: detyrime financiare nëpërmjet pasqyrës së fitimeve dhe humbjeve, kredi dhe borxhe, llogari të pagueshme, ose si derivate të destinuara si instrumenta mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas përkatësisë. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe borxheve dhe llogarive të pagueshme, njihen neto me kostot direkte të transaksionit.

Aktivitetet afatgjata materiale.

**Njohja dhe matja*

Aktivitetet e trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur. Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj. Kur pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të trupëzuara.

**Kostot e metejshme*

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

**Amortizimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe llogaritet me metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen sipas më të voglës midis jetëgjatësisë së aktivitetit dhe kohës së huasë, përveçse kur është e qartë se shoqëria do të fitojë pronësinë në përfundim të kontratës së qirasë. Toka nuk zhvlerësohet.

Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Makineri dhe pajisje	Metoda Lineare	20%
Automjete	Metoda Lineare	20%
Kompjuter dhe pajisje informatike	Metoda Lineare	25%
Mobilje zyre	Metoda Lineare	20%
Aktive të tjera	Metoda Lineare	20%

Vlera e mbetur e aktivitetit, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme në fund të çdo periudhe raportuese.

Inventarët.

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve përfshin shpenzimet që ndodhin në blerjen e tyre, prodhimin ose këmbimin dhe kosto të tjera për t'i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Kosto përfshin edhe një pjesë të përshtatshme të kostove operacionale bazuar në kapacitetin normal operacional. Vlera neto e realizueshme është çmimi i parashikuar i shitjes në aktivitetin normal të biznesit duke hequr kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin. Shoqëria ofron format e mëposhtme të përfitimëve për punonjësit e saj:

**Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë benefite pensioni për punonjësit në moshën e pensionit. Kontributet e Shoqërisë regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) kur ndodhin.

**Leje vjetore e paguar*

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

Tatim fitimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë.

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% (2023: 15%) e të ardhurës së tatueshme. Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhë të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e monedhës Lekë (ALL) me Euro (EUR) dhe Dollar Amerikan (USD) më 31 dhjetor 2023 dhe më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Euro	98.15	103.88
USD	94.26	93.94

Llogari të arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Qiratë.

Përcaktimi nëse një marrëveshje është apo përmban një qira bazohet në thelbin ekonomik të marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi apo i disa aktiveve të veçanta dhe marrëveshja kalon të drejten e përdorimit të aktivit.

Qiratë financiare të cilat transferojnë të gjitha rreziqet dhe përfitimet si pasojë e pronësisë së aktivit të marrë me qira, kapitalizohen në fillim të qirasë me vlerën e drejtë të pronës që merret me qira ose, kur është më e vogël, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në aktive

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

afatgjata materiale me detyrimin përkates ndaj qiradhënësit të përfshirë në detyrime të qirasë financiare. Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe reduktimit të detyrimit.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohej nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit. Shoqëria ka njohur:

(a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe

(b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

Njohja e të ardhurave.

Të ardhurat përfaqësojnë hyrjen e përfitimeve ekonomike bruto përgjatë rrjedhjes normale të biznesit. Kur këto hyrje rezultojnë në rritje të kapitalit, ndryshe nga rritjet që vijnë si kontribute të aksionerëve. Të ardhurat përfaqësojnë vlerën e drejtë të hyrjeve apo të llogarive të arkëtueshme nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, në rrjedhen normale të biznesit. Të ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet apo skontot pasi janë eliminuar shitjet brënda shoqërisë, nëse ka. Të ardhurat nga shërbimet njihen në kohën që shërbimi ofrohet. Të ardhurat nga shërbimet njihen në periudhën kontabël që shërbimi ofrohet duke i'u referuar fazës së realizimit të transaksionit, bazuar në vlerësimin e shërbimit të realizuar aktualisht në lidhje me totalin e shërbimit që do të ofrohet. E ardhura nga qiraja e ambjenteve të dhena me qira njihet në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë kohës së qirasë.

Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative.

Angazhime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme ta konfirmojnë atë, një detyrim që ka lindur deri më datën e raportimit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)***1. Mjete monetare dhe të ngjashme.**

Mjetet monetare në 31 Dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

Mjete monetare	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare ne banke	4,668,505	168,427,166
Mjete monetare ne arke	2,064	35,477
Totali	4,670,569	168,462,643

Vlera monetare në bankë dhe në arkë paraqiten si më sipër duke përdoruar kursin e këmbimit në mbyllje të cdo viti ushtrimor, respektivisht për 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023.

2. Te drejta te arkëtueshme tregtare

Të drejtat e arkëtueshme tregtare ndaj klienteve dhe debitorve te shoqerise në 31 Dhjetor 2024 janë sipas tabelës që vijon :

Te drejta te arkëtueshme	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Te drejta te arkëtueshme kliente	3,158,151,649	4,019,415,723
Debitore te tjere (Llog 461)	448,798,690	598,806,243
Debitore furnitore (401)	454,458,329	629,789,360
Parapagime te dhena	430,539,948	240,609,638
Te drejta te tjera tatimore	13,606	83,208,102
Totali	4,491,962,222	5,571,829,066

Të drejta të arkëtueshme janë pa interes dhe përbëhen nga të arkëtueshme që kanë afat arkëtime nga më të ndryshmet, si klientë që priten të arkëtohen brënda 30 ditëve, 60 ditëve, 90 ditëve dhe përtej 120 ditëve.

3. Inventaret

Vlerësimi i gendjeve të inventarit me 31.12.2024 është bërë në përputhje me parimet kontabile dhe detajohet si më poshtë vijon:

Inventare	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Materiale te para	695,097,024	634,529,649
Materiale ndihmese	264,049	327,750
Inventar i imet	11,314,187	12,381,727
Punime dhe prodhime ne proces	8,373,643,082	8,207,186,062
Mallra	-	1,738,382
Totali	9,080,318,341	8,856,163,570

4. Shpenzime te periudhave te ardhshme (te shtyra)

Vlera e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra me 31.12.2024 rezulton si vijon

Parapagime dhe shpenzime te shtyra	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagime,shpenzime te shtyra	390,634,377	231,528,507
Totali shpenzime per tu shperndare	390,634,377	231,528,507

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)***5. Aktivet afat gjata materiale**

Gjendjet e aktiveve afatgjata materiale me 31.12.2024 janë si vijon :

Emertimi	Toka ,terrene, troje	Ndertim. Instali me pergithshme	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje dhe pajisje	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>							
Gjendje 31.12.2023	12,169,000	-	99,057,683	22,930,968	10,385,763	38,418,939	182,962,353
Shtesa	-	-	2,435,106	4,337,600	1,512,152	8,932,476	17,217,334
Pakesime	-	-	-	-	1,589,642	25,121,963	26,711,605
Gjendje 31.12.2024	12,169,000	-	101,492,789	27,268,568	10,308,273	22,229,452	173,468,082
<i>Amortizimi</i>							
Gjendje ne 31.12.2023	-	-	36,622,982	6,372,628	7,236,385	15,982,448	66,214,443
Shtesa llogaritur	-	-	12,660,651	3,425,243	1,827,406	2,432,183	20,345,483
Pakesime	-	-	-	-	1,418,135	13,064,059	14,482,194
Gjendje ne 31.12.2024	-	-	49,283,633	9,797,871	7,645,656	5,350,572	72,077,732
<i>Vlera neto 31.12.2023</i>	<i>12,169,000</i>	<i>-</i>	<i>62,434,701</i>	<i>16,558,340</i>	<i>3,149,378</i>	<i>22,436,491</i>	<i>116,747,910</i>
<i>Vlera neto 31.12.2024</i>	<i>12,169,000</i>	<i>-</i>	<i>52,209,156</i>	<i>17,470,697</i>	<i>2,662,617</i>	<i>16,878,880</i>	<i>101,390,348</i>

6. Aktivet afatgjata jomateriale

Gjendjet e aktiveve afatgjata jo - materiale me 31.12.2024 janë si vijon :

Aktive afatgjata Jo materiale (vlera neto kontabile)	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Softwer informatik	4,344,366	-
Totali	4,344,366	-

7. Detyrime te pagueshme furnitor

Llogaria furnitor është e përbërë kryesisht nga llogarite e pagueshme tregtare ndaj paleve te treta me maturitete të ndryshme nga të pagueshme deri në 30 ditë, 90 ditë deri në 1 vit. Detyrimet ndaj furnitoreve dhe kreditoreve me 31.12.2024 rezutojnë si vijon :

Detyrime te pagueshme furnitor	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime te pagueshme furnitor	2,538,622,022	2,262,540,147
Detyrime kreditore lloga (461)	1,825,132,708	659,344,368
Totali	4,363,754,730	2,921,884,515

8. Arketime ne avance per porosi

Arketime ne avance per porosi deri me 31 dhjetor 2024 dhe me 31 dhjetor 2023 rezulton si vijon :

Arketime ne avance per porosi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Arketime ne avance per porosi (409)	5,412,555,594	6,378,497,264
Totali	5,412,555,594	6,378,497,264

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)***9. Detyrime personeli dhe sigurime shoqerore**

Llogari të pagueshme ndaj punonjesve me 31.12.2024 perfaqeson kryesisht detyrimin për pagat e muajit dhjetor ndaj punonjesve, detyrimin për kontributin e sigurimeve shoqerore, etj, të cilat shoqëria i ka paguar muajin pasardhës dhe keto detyrime me 31.12.2024 rezultojnë si vijon :

Te pagueshme ndaj punonjesve	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paga dhe shperblime	1,565,533	-
Sigurimet Shoqerore dhe Shendetsore	10,436,288	5,984,429
Totali	12,001,821	5,984,429

10. Huatë nga institucionet financiare (overdraft)

Huatë ndaj institucioneve bankare deri më 31 dhjetor 2024, 31 dhjetor 2023 përbehen si më poshtë :

Huatë financiare overdraft	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Hua financiare overdraft	1,009,781,147	1,159,645,400
Totali	1,009,781,147	1,159,645,400

Shoqëria ka marrë hua bankare (overdraft) në banka të ndryshme e cila është marrë për financimin e aktivitetit ekonomik të shoqërisë dhe për investimin e kryer në ndërtimin e godinës.

11. Detyrimet e tjera

Detyrimet e tjera në 31 dhjetor 2024, perfaqsojnë detyrime ndaj kreditorëve të tjerë si dhe detyrime të papaguara të shoqërisë ndaj organit tatimor që janë për TAP, Tatim mbi fitimin, TVSH si dhe Tatim në Burim. Detyrimet e tjera të pagueshme me 31.12.2024 janë si vijon

Detyrime të tjera të pagueshme	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrime ndaj kreditorëve të tjerë	60,245,756	781,758,295
Detyrime tatimore tatimi fitimi	5,069,224	-
Detyrime tatimore (tvsh ,tatim në burim)	821,607	-
Totali	66,136,587	781,758,295

12. Detyrimet afatgjata (hua nga ortakët)

Për financimin e aktivitetit ekonomik të saj shoqëria ka marrë hua nga ortakët i vetëm i saj Kastrati Energy Trade sh.a , dhe nga paletë të lidhura me shoqërinë dhe gjendja huave afatgjate e më 31.12.2024 është si vijon :

Huamarrje afatgjate	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Huamarrje financim ortakë dhe pale të lidhura	2,618,955,918	3,183,614,610
Totali	2,618,955,918	3,183,614,610

13. Hua bankare afatgjate

Huatë ndaj institucioneve bankare deri më 31 dhjetor 2024, 31 dhjetor 2023 përbehen si më poshtë

Huatë financiare afatgjate	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Hua financiare bankare	90,481,511	140,404,927
Totali	90,481,511	140,404,927

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK

Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)

Shoqëria ka marre hua bankare (overdraft) ne banka te ndryshme e cila eshte marre per financimin e aktivitetit ekonomik te ndertimit si dhe per investimin ne ndertimin e godines.

14. Kapitali i dhe rezevat

Kapitali i shoqërisë me 31.12.2024 zotërohet 100 % nga ortakët i saj i vetëm që është shoqëria Kastrati Energy Trade sh.a. Kapitali dhe rezervat me 31.12.2024 rezultojnë si vijon :

Kapitali	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kapitali aksionar	181,400,000	181,400,000
Fitimi i pashperndare	191,542,251	178,360,129
Fitimi ushtrimor	126,710,664	13,182,122
Totali	499,652,915	372,942,251

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit.

Të gjitha të ardhurat e shoqërisë janë realizuar kryesisht nga shërbimet e procesit të ndërtimit për kliente të ndryshëm si dhe të ardhura për shitjen e pasurisë së palujtëshme dhe shërbime të tjera si vijon :

Të ardhurat nga Aktiviteti	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit	4,224,917,714	2,682,047,524
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	54,343,599	3,664,485
Totali	4,279,261,313	2,685,712,009

16. Lenda e pare , materiale te tjera te konsumueshme

Shoqëria ka pasqyruar vlerën e kostos së materialeve para si dhe të materialeve të tjera të konsumueshme për vitin ushtrimor 2024 të cilat rezultojnë si vijon :

Lenda e pare dhe materiale te tjera te konsumueshme	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(2,473,403,364)	(1,342,014,380)
Te tjera shpenzime	(79,336,017)	(35,082,132)
Totali	(2,552,739,382)	(1,377,096,513)

17. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet për paga dhe shpërblime ndaj personelit janë në tabelën si vijon:

Shpenzime te personelit	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Paga dhe shperblime	(228,027,264)	(185,963,587)
Sigurime shoqerore e shendetesore	(33,851,463)	(29,192,868)
Totali	(261,878,727)	(215,156,455)

18. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shoqëria ka llogaritur amortizimin e aktiveve afatgjata në përputhje me normat e amortizimit tatimor, dhe vlera e amortizimit vjetor është pasqyruar si shpenzim në vitin 2024 rezultojnë si vijon :

KASTRATI CONSTRUCTION SHPK**Shënimet shpjeguese për periudhën financiare deri më 31 Dhjetor 2024***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë)*

Shpenzime konsumi dhe amortizimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Konsumi/amortizimi i aktiveve afatgjata	(20,522,369)	(18,738,285)
Totali	(20,522,369)	(18,738,285)

19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit të kryera për qellim të aktivitetit janë detajuar si më poshtë :

Shpenzime të tjera shfrytëzimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Trajtime të përgjithshme	(1,113,640,971)	(986,970,622)
Sigurime	(10,249,447)	(389,796)
Shpenzime postare telekomunikimi	(1,886,299)	(1,406,001)
Shpenzime transporti blerje	(3,441,899)	(12,610,486)
Sherbime bankare	(1,358,714)	(2,325,308)
Taksa , tatime dhe tarifa vendore	(13,702,678)	(6,529,722)
Shpenzime për pritje dhe perfaqsim	(1,751,287)	(290,094)
Gjoha, kamatvonesa dhe demshperblime	(953,688)	(9,062,724)
Totali	(1,146,984,983)	(1,019,584,754)

20. Te ardhura /(shpenzime) të tjera financiare

Vlera të ardhurave të tjera financiare perfaqeson vlerën neto kontabile të AAM të shitura dhe të nxjerra jashtë përdorimit dhe rezultojnë si vijon :

Te ardhura të tjera	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Te ardhura të tjera (Vlera neto kontabile e AAM)	(12,229,411)	-
Totali	(12,229,411)	-

21. Te ardhura /(Shpenzime) interesi financiar

Shpenzimet për interesat e llogaritur për humarrjet nga ortakët dhe pale të treta , kredite bankare overdraft të cilat janë pasqyruar si shpenzim në vitin ushtrimor 2024 rezultojnë si vijon :

Te ardhura /shpenzime financiare të tjera	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Te ardhura të tjera financiare/shpenzime për interesa	(77,746,102)	(55,101,812)
Totali	(77,746,101)	(55,101,813)

22. Te ardhura nga kembimi

Në këtë tabelë janë evidentuar fitimet/(humbjet) neto nga kembimi gjatë aktivitetit të shoqërisë në varesi të ecurisë së kursit të monedhës.

Te ardhura /shpenzime financiare të tjera	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitim nga kembimet dhe perkthimet valutore	702,091	-
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	(56,411,223)	17,004,057
Te ardhura/ (shpenzime) të tjera financiare	(607,763)	129,346
Totali	(56,316,894)	17,133,403